



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:299150

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06604595

C.nr.9782/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Albana Çeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.M, B.R, F. Xh.H dhe S.G që të gjitha nga P, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokat, L.M me seli në P, Rr. “.....”, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit (transportit), jashtë seancës gjyqësore, më datë 16.12.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve, F.M, B.R, F. Xh.H dhe S.G që të gjitha nga Prishtina dhe OBLIGOHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimin për shpenzimet e udhëtimit (transportit), t’iu paguaj shumat si në vijim:

Paditëses F.M, për periudhën nga data 01.12.2020 deri më 21.11.2022 apo për 364 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 203.04 € (dyqind e tre euro e katër cent);

Paditëses B.R, për periudhën nga data 01.12.2020 deri më 21.11.2022 apo për 364 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 203.04 € (dyqind e tre euro e katër cent);

Paditëses F.XH.H, për periudhën nga data 01.02.2021 deri më 21.11.2022 apo për 319 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 178.64 € (njëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e gjashtëdhjetë e katër cent) dhe

Paditëses S.G, për periudhën nga data 01.02.2021 deri më 21.11.2022 apo për 319 ditë, shumën e përgjithshme prej 178.64 € (njëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e gjashtëdhjetë e katër cent).

II. Të gjitha shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, shuma prej 763.36 €, gjykohen së bashku me kamatën ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë gjegjësisht data 21.12.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

III. REFUZOHET, pjesa tjetër e kërkesëpadisë për paditëset F.M dhe B. R, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, përtej shumës së gjykuar nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, për periudhën 17.04 2017 deri më 30.11.2020, apo për 575 ditë dhe atë për secilën paditëse veç e veç në shumë prej 322.00 € apo në shumën e përgjithshme prej 644.00 €, SI E PABAZUAR.

IV. OBLIGOHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditësve, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 280.00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datën 21.12.2023, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit (transportit).

I autorizuari i paditësve në padinë dhe kërkesëpadi, ka theksuar se paditëset janë të punësuara pranë të paditurës ku secila prej tyre është e punësuar në pozitën Mësimdhënëse në Sh.F.M.U “.....”, . Paditësja e parë, nga data 18.04.2017 deri me datën 21.11.2022 ka realizuar 939 ditë të pranisë në punë, e njëjta ka vendbanimin në .. ndërsa Sh.F.M.U “...”, ku dhe punon paditësja ka adresë në Rr.

Nga këto prova rezulton se vendbanimi i paditëses është në një lokacion ndryshe prej vendit të saj të punës. Në kuponët fiskal vërtetohet fakti se çmimi i biletës një drejtimesh i “Trafikut Urban” me të cilin ka udhëtuar paditësja është 0.40 euro, duke qenë se paditësja ka udhëtuar në të dy drejtimet i bie se e njëjta ka krijuar shpenzime në shumen prej 0.80 euro për udhëtimin e saj ditor (vendbanim-vendi i punës dhe anasjelltas), andaj paditësja e parë në emër të shpenzimeve të udhëtimit i takon shpërblimi në shumën prej 525.84 euro, shumë kjo e cila nxirret nga shumëzimi i ditëve të pranisë në punë me shumën 0.56 euro, e cila paraqet 70% të vlerës prej 0.80 euro të biletave (në dy drejtimet) të udhëtimit të paditëses nga vendbanimi i tij deri në vendin e punës (939 ditë x0.56 euro=525.84 euro).

Paditësja e dytë, nga data 18.04.2017 deri me datën 21.11.2022 ka realizuar 939 ditë të pranisë në punë, e njëjta ka vendbanimin në Rr., ndërsa Sh.F.M.U “...”, ku dhe punon paditësja ka adresë në Rr.

Nga këto prova rezulton se vendbanimi i paditëses është në një lokacion ndryshe prej vendit të saj të punës. Në kuponët fiskal vërtetohet fakti se çmimi i biletës një drejtimesh i Trafikut Urban me të cilin ka udhëtuar paditësja është 0.40 euro, duke qenë se paditësja ka udhëtuar në të dy drejtimet i bie se e njëjta ka krijuar shpenzime në shumen prej 0.80 euro për udhëtimin e saj ditor (vendbanim-vendi i punës dhe anasjelltas). Tutje ka shtuar se nga vërtetimet e ditëve te punës vërtetohet fakti se paditësja nga data 18.04.2017 deri më 21.11.2022 ka gjithsej 939 ditë pune, atëherë paditësja e parë në emër të shpenzimeve të udhëtimit i takon shpërblimi në shumën prej 525.84 euro, shumë kjo e cila nxirret nga shumëzimi i ditëve të pranisë në punë me shumën 0.56 euro, e cila paraqet 70% të vlerës prej 0.80 euro të biletave (në dy drejtimet) të udhëtimit të paditëses nga vendbanimi i tij deri në vendin e punës (939 ditë x0.56 euro=525.84 euro).

Paditësja e tretë, nga data 01.02.2021 deri me datën 21.11.2022 ka realizuar 319 ditë të pranisë në punë, e njëjta ka vendbanimin në, ndërsa Sh.F.M.U “...”, ku dhe punon paditësja ka adresë në... Nga këto prova rezulton se vendbanimi i paditëses është në një lokacion ndryshe prej vendit të saj të punës. Në kuponët fiskal vërtetohet fakti se çmimi i biletës një drejtimesh i Trafikut Urban me të cilin ka udhëtuar paditësja është 0.40 euro, duke qenë se paditësja ka udhëtuar në të dy drejtimet i bie se e njëjta ka krijuar shpenzime në shumen prej 0.80 euro për udhëtimin e saj ditor (vendbanim-vendi i punës dhe anasjelltas).

Tutje ka shtuar se nga vërtetimet e ditëve të punës vërtetohet fakti se paditësja nga data 01.02.2021 deri me datën 21.11.2022 ka realizuar 319 ditë të pranisë në punë, atëherë paditësja e parë në emër të shpenzimeve të udhëtimit i takon shpërblimi në shumën prej 178.64 euro, shumë kjo e cila nxirret nga shumëzimi i ditëve të pranisë në punë me shumën 0.56 euro, e cila paraqet 70% të vlerës prej 0.80 euro të biletave (në dy drejtimet) të udhëtimit të paditëses nga vendbanimi i tij deri në vendin e punës (319 ditë x0.56 euro=525.84 euro).

Ndërsa lidhur me paditësen e katërt, , ka theksuar se paditësja nga data 01.02.2021 deri me datën 21.11.2022 ka realizuar 319 ditë të pranisë në punë, e njëjta ka vendbanimin në Rr. ndërsa Sh.F.M.U “.....”, ku dhe punon paditësja ka adresë në Rr.

Nga këto prova rezulton se vendbanimi i paditëses është në një lokacion ndryshe prej vendit të saj të punës. Në kuponët fiskal vërtetohet fakti se çmimi i biletës një drejtimesh i Trafikut Urban me të cilin ka udhëtuar paditësja është 0.40 euro, duke qenë se paditësja ka udhëtuar në të dy drejtimet i bie se e njëjta ka krijuar shpenzime në shumën prej 0.80 euro për udhëtimin e saj ditor (vendbanim-vendi i punës dhe anasjelltas).

Tutje ka shtuar se nga vërtetimet e ditëve të punës vërtetohet fakti se paditësja nga data 01.02.2021 deri me datën 21.11.2022 ka realizuar 319 ditë të pranisë në punë, atëherë paditësja e parë në emër të shpenzimeve të udhëtimit i takon shpërblimi në shumën prej 178.64 euro, shumë kjo e cila nxirret nga shumëzimi i ditëve të pranisë në punë me shumën 0.56 euro, e cila paraqet 70% të vlerës prej 0.80 euro të biletave (në dy drejtimet) të udhëtimit të paditëses nga vendbanimi i tij deri në vendin e punës (319 ditë x0.56 euro=525.84 euro).

Andaj, konformë nenit 35, paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit , parashihet; “ *Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”, paditësve u takon kompensimi shpenzimeve të udhëtimit, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të pranuar në gjykatë me datë 07.11.2024 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit po ashtu në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi pasi konformë dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*..

Ndërsa, lidhur me pjesën e refuzuar gjykata ka vendosur konform dispozitës së nenit 399 të LPK-së, e cila përcakton: neni 399.1 *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia neni 399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe analizimi i përgjigjes në padi, gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese rrethana se paditëset janë të punësuar tek e paditura. Nga provat e bashkëngjitura në padi, gjykatës i rezulton se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht si Mësimdhënëse, një fakt i tillë vërtetohet nga kontratat e punës për me nr.prot.116 e datës 17.08.2015, nr.prot.100 e datës 11.09.2013, nr.prot.108 e datës 10.09.2014 dhe nr.prot.91 e datës 01.09.2012.

Për paditësen e parë, ditët e punës në shkollë vërtetohen nga vërtetimet e punës, nr.prot.2004/21 datë 29.01.2021, nr.prot.2336/21 datë 04.03.2022, nr.prot.384/23 datë 19.10.2023, ndërsa, nga Certifikata e Vendbanimit vërtetohet se paditësja ka adresë të vendbanimit në .., ndërsa adresa e të paditurës rezulton të jetë ndryshe nga vendi i paditëses, kurse nga biletat e autobusit lëshuar nga „Trafiku Urban” SH.A, Prishtinë, bashkëngjitur në formë të kuponit fiskal rezulton se paditësja nga vendbanimi i saj për në vendin e punës dhe anasjelltas ka paguar biletë ditore prej 0.80 Euro.

Për paditësen e dytë ditët e punës në shkollë, vërtetohen nga vërtetimet e punës nr.prot.2010/21 datës 29.01.2021, nr.prot.1983/21 datës 29.01.2021, nr.prot.2313/22 datës 04.03.2022 dhe nr.prot.408/23 datës 19.10.2023, ndërsa, nga Certifikata e Vendbanimit, vërtetohet se paditësja ka adresë të vendbanimit në .., ndërsa adresa e të paditurës rezulton të jetë ndryshe nga vendi i paditëses, kurse nga biletat e autobusit lëshuar nga „Trafiku Urban” SH.A, Prishtinë, bashkëngjitur në formë të kuponit fiskal rezulton se paditësja nga vendbanimi i saj për në vendin e punës dhe anasjelltas ka paguar biletë ditore prej 0.80 Euro.

Për paditësen e tretë, ditët e punës në shkollë vërtetohen nga vërtetimet e punës nr.prot.2314/22 datës 04.03.2022, dhe nr.prot.407/23 datës 19.10.2023, ndërsa, nga Certifikata e Vendbanimit vërtetohet se paditësja ka adresë të vendbanimit në .., ndërsa adresa e të paditurës rezulton të jetë ndryshe nga vendi i paditëses, kurse nga biletat e autobusit lëshuar nga „Trafiku Urban” SH.A, Prishtinë, bashkëngjitur në formë të kuponit fiskal rezulton se paditësja nga vendbanimi i saj për në vendin e punës dhe anasjelltas ka paguar biletë ditore prej 0.80 Euro.

Për paditësen e katërt, ditët e punës në shkollë vërtetohen nga vërtetimet e punës nr.prot.2318/22 datës 04.03.2022, dhe nr.prot.403/23 datës 19.10.2023, ndërsa, nga Vërtetimi nr.prot. 122/2022 datë 01.11.2022 , vërtetohet se paditësja ka adresë të vendbanimit në .. ndërsa adresa e të paditurës rezulton të jetë ndryshe nga vendi i paditëses, kurse nga biletat e autobusit lëshuar nga „Trafiku Urban” SH.A, Prishtinë, bashkëngjitur në formë të kuponit fiskal rezulton se paditësja nga vendbanimi i saj për në vendin e punës dhe anasjelltas ka paguar biletë ditore prej 0.80 Euro.

Provave materiale të lartcekura, gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 paragrafi 1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”* Ndërkaq, sa i përket biletave të transportit publik të bashkëngjitura nga paditësi, duke qenë se të njëjtat janë lëshuar në formë të kuponit fiskal, nga një ndërmarrje e regjistruar dhe me numër të regjistruar fiskal, gjykata të njëjtat i konsideroi si prova të besueshme. Për më tepër, të njëjtat nuk u kontestuan as nga pala e paditur.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkuara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, respektivisht me datë 22.01.2021. Kjo për faktin se kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit (transportit) për ditët e pranisë në punë përfshinë periudhat si në vijim: për paditësen e parë dhe paditësen e dytë periudha kohore nga data 01.12.2020 deri më datën 21.11.2022, ndërsa për paditësen e tretë dhe paditësen e katërt periudha kohore 01.02.2021 deri më 21.11.2022, të cilat gjejnë mbështetje në kontrata e referuara më lartë.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të transportit për ditët e pranisë në punë, në mënyrë identike parashihet me dispozitën nga neni 35 paragrafi 5 të të dy kontratave të lartcekura, ku ndër tjera është përcaktuar se: *“...Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punon i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.*

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësi është i legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Referuar dispozitave të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar. Mbi këtë bazë, lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve për transport, është bërë përlllogaritja në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë janë shumëzuar me 70% të shumës së shpenzuar në trafikun urban në relacionin shtëpi – punë dhe anasjelltas.

Kështu, bazuar në faktin se nga provat e administruara u vërtetua se paditëset për periudhën kohore të specifikuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për ditët e prezencës në punë, në relacionin shtëpi – punë dhe anasjelltas secila veç e veç, në ditë kanë shpenzuar 0.80 € në trafik urban, me një përlllogaritje të thjeshtë ($70\% \text{ e } 0.80 \text{ €} = 0.56$) mund të konkludohet se të njëjtave secilës veç e veç i'u takon kompensimi në shumën e përgjithshme si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadiës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke vlerësuar pretendimet e të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria komunale e Arsimit lidhur me atë se kërkesëpadia e paditësit përmban kërkesa të parashkruara dhe të njëjtin pretendim e gjeti si pjesërisht të bazuar, për faktin se me dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Në rastin konkret kërkesëpadia e paditësve F.XH.H dhe S.G përfshinë periudhën nga 18.04.2017 e deri me 22.11.2022, e që rrjedhimisht lidhur me kërkesat për periudhën nga data 18.04.2017 e deri më datën 22.11.2022, në shumë prej 644.00 €, kemi parashkrim të kërkesave, pasi që padia në gjykatë është paraqitur me datë 21.12.2023, që nënkupton se e njëjta është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor të paraparë me dispozitën e lartcekur.

Përkitazi me këtë vlerësim, Gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A.Su.A.nr.214/2023, të datës 09.10.2023 (shih: pika III e këtij mendimi juridik). Andaj, për këto periudha gjykata refuzoi kërkesën për kompensim në emër të udhëtimit, përkatësisht për periudhën prill 2017 deri më 30.11.2020, apo për 575 ditë dhe atë për secilën paditëse veç e veç në shumë prej 322.00 € (treqind e njëzetë dy euro).

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që bazohen në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, por një pretendim është tërësisht i pabazuar për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 paragrafi 1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: “Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”.

Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e kësaj kontrate, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratës Kolektive të lartcekur, në njërën anë janë paraparë të drejta për njërën palë, e në anën tjetër janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësja t’i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, mbi bazën e plotësisht të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ta paguajë së bashku me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila kamatë do të fillojë të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, 21.12.2023 e deri në pagesën definitive të shumës si në pikën I të dispozitivit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësve, si palë gjyqfituese t'ua kompensojë shumën e shpenzimeve në vlerë të përgjithshme prej 280.00 €, dhe atë 260.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe 20.00 € në emër të taksës për padi.

Bazuar në të lartcekurat, në bazë të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.9782/2023, datë 13.12.2024

Gj y q t a r j a
Albana Çeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.